




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr. 28, datë 22.11.2023



**PËR**  
**RINOVIMIN E LEJES ME NR.56 PROT., DATË 23.7.2018 DHËNË**  
**ME VENDIM NR.44/2 DATË 13.7.2018 NGA KBU SHKUMBIN**  
**“PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME**  
**TË NDRYSHME”,**  
**SUBJEKTIT “KURUM INTERNATIONAL”SH.A**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me nr.56 prot., datë 23.7.2018 dhënë me vendim nr.44/2 datë 13.7.2018 nga KBU Shkumbin për “Përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime të ndryshme (sanitare)” subjektit “Kurum International”sh.a me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh Elbasan Qarku Elbasan:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- X= 502373.3 ; Y= 4550920.3 ; Z= 107 m.m.n.d



- Prurja e kërkuar:  $Q= 0.00014 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektivit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

